



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE E GJELBËRIMIT
DREJTORIA PLANIFIKIMEVE MENAXHIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **“Power Industries” me Nipt: L51706022H** me Adresë: Bulervard Gjergj Fishta, Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati i 5, Apartamenti 14, Tiranë, me Administrator Z. Andi Marku.

- 1.Procedura e prokurimit: **Kërkesë për Propozim**
- 2.Numri i References se Proçedures: **REF-57425-05-05-2020**
- 3.Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Blerje mjete motorrike, elektrike (bicikletë me tre rrota dhe kosh, elektropompa e paisje të tjera)**
4. Fondi Limit: **6 666 000** (gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë e mijë) **lekë pa tvsh**
5. Burimi i të ardhurave: **Bashkia Tiranë.**
6. Kohëzgjatja e kontratës: 10 ditë nga data e lidhjes së kontratës
7. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët
8. Data e zhvillimit të procedures: **01.06.2020 ora 11:00**

Njoftojme se kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik **“AZ Trading”** me NIPT: **L81515016F** me ofertë ekonomike: 5 390 000 (pesë milion e treqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh dhe 6 468 000 (gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë me tvsh.

2. **Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Ledio-06” me NIPT: K61931007D me ofertë ekonomike 6 245 000 (gjashtë milion e dyqind e dyzet e pesë mijë) lekë pa tvsh dhe 7 494 000 (shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë me tvsh.**
3. **Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Luar Bros” me NIPT: L72322004M me ofertë ekonomike 5 453 000 (pesë milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë pa tvsh dhe 6 543 600 (gjashtë milion e pesëqind e dyzet e tre mijë e gjashtëqind) lekë me tvsh.**
4. **Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Power Industries” me NIPT: L51706022H me ofertë ekonomike 6 290 000 (gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh dhe 7 548 000 (shtatë milion e pesëqind e dyzet e tetë mijë) lekë me tvsh.**
5. **Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “SI &CO Company” me NIPT: L21420002F me ofertë ekonomike 6 435 000 (gjashtë milion e katërqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë pa tvsh dhe 7 722 000 (shtatë milion e shtatëqind e njëzet e dy mijë) lekë me tvsh.**

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. **Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “AZ Trading” me NIPT: L81515016F**

Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi “AZ Trading”

- **I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim**
- **Nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST**

OE AZ Trading nuk plotëson pikën 2.3 (a) të kapacitetit teknik pasi gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurave nuk ka paraqitur furnizime të ngjashme (kontrata me ente publike apo fatura tatimore shitjeje me sektorin privat) me vlerën jo më të vogël se 39%. Pra furnizimet e ngjashme në kontratat e paraqitura janë me vlerë më të ulët se 39% e fondit limit.

OE AZ Trading nuk plotëson pikën 2.3 (d) të kapacitetit teknik pasi:

Motosharra profesionale e madhe nuk plotëson kriteret teknike pasi modeli i paraqitur nga OE AZ Trading (Husqvarna 365) ka një zhvendosje prej 70.6 cc ndërkohë që sipas specifikimeve teknike nuk duhet të jetë më e vogël se 70.7 cc (apo cm^3).

Motosharra profesionale e mesme modeli i paraqitur (543 XP) nuk plotëson kriteret teknike pasi fuqia është më e vogël se 2.2 kW si dhe pesha pa pajisje prerëse është më e vogël se 4, 5 kg.

Motoseka profesionale (krasitëse degësh) modeli 525P5S pasha pa përfshirë pajisjet e prerjes është 6.3 kg, ndërkohë që tek specifikimet teknike pasha minimale është kërkuar 7kg. Ndërkohë që niveli i vibrimeve (doreza e milingonave) është 2.9/3.2 dhe sipas specifikimeve teknike nuk duhet të jetë jo më i vogël se 5.3m/s². Motokosa Profesionale (filispanjë) paraqitur nga OE AZ Trading modeli 525RX ka një zhvendosje cilindri prej 25.4 ndërkohë që sipas specifikimeve teknike zhvendosja e cilindrit nuk duhet të jetë më e vogël se 50.6 cm³, ndërkohë që gjithashtu ka një fuqi më të ulët se 2.3 kW siç edhe është kërkuar në specifikime teknike. Modeli i paraqitur nga OE AZ Trading 525RX ka një fuqi prej 1.3 hp ose 0.96 kW.

Makina korrëse profesionale me karburant e paraqitur nga OE AZ Trading nuk plotëson kriteret teknike pasi tek specifikimet teknike është përcaktuar që makina duhet të ketë një fuqi neto RPM jo më të vogël se 3100 rpm, ndërkohë që makina korrëse profesionale paraqitur nga OE AZ Trading Husqvarna R322T AWD është më e ulët se 3100 rpm, përkatësisht 3000 rpm. Prerësja e degëve profesionale nuk përmbush specifikimet teknike pasi AK tek specifikimet teknike ka kërkuar që gjatësia e tehut të mos jetë më e ulët se 75 cm, ndërkohë që prerësja e degëve profesionale 522HD60S ka një gjatësi tehu prej 24 inch ose 60.96 cm. Gjithashtu hapja e dhëmbëve sipas specifikimeve duhet të jetë jo më e vogël se 28mm, ndërkohë që prerësja e degëve profesionale 522HD60S paraqitur nga AZ Trading ka një hapje dhëmbësh prej 1.2 mm.

Prerësja e degëve profesionale nuk përmbush specifikimet teknike pasi peshon 7.6 kg, ndërkohë që sipas specifikimeve duhet të jetë jo më e vogël se 9kg. Gjithashtu doreza e përparme e nivelit ekuivalent të dridhjeve nuk rezulton të jetë sipas specifikimeve teknike pasi rezulton të jetë 2.9 m/s², ndërkohë që sipas specifikimeve teknike duhet të ishte jo më i vogël se 3.6m/s².

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Ledio-06” me NIPT: K61931007D

Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi “Ledio-06”

- Nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- Nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST

OE Ledio-06 nuk plotëson pikën (a) tek kriteret e përgjithshme të kualifikimit pasi nuk e ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

OE Ledio-06 nuk plotëson pikën (d) pasi nuk ka paraqitur kopje të noterizuar të ofertës teknike.

3. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Luar Bros” me NIPT: L72322004M

Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi “Luar Bros”

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- Nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST

OE Luar Bros nuk plotëson pikën 2.3 (c) të specifikimeve teknike pasi nuk ka paraqitur çertifikatën ISO 9001; 2015 të prodhuesit siç është kërkuar nga AK tek kapaciteti teknik.

OE Luar Bros nuk plotëson pikën 2.3 (a) të kapacitetit teknik pasi gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurave nuk ka paraqitur furnizime të ngjashme (kontrata me ente publike apo fatura tatimore shitjeje me sektorin privat) me vlerën jo më të vogël se 39%. Pra furnizimet e ngjashme në kontratat e paraqitura janë me vlerë më të ulët se 39% e fondit limit.

OE Luar Bros nuk plotëson pikën 2.3 (d) të kapacitetit teknik pasi:

Motokosa Profesionale (filispanjë) paraqitur nga OE Luar Bros modeli Husqvarna 525RJX ka një zhvendosje cilindri prej 25.4 ndërkohë që sipas specifikimeve teknike zhvendosja e cilindrit nuk duhet të jetë më e vogël se 50.6 cm³. Motokosa Profesionale (filispanjë) paraqitur nga OE Luar Bros modeli Husqvarna 525RJX ka një peshë më të vogël se 12.1 kg.

Motosteka profesionale (pa përfshirë pajisjet prerëse) sipas specifikimeve teknike duhet të ketë një peshë jo më të vogël se 7 kg, ndërkohë që modeli I paraqitur nga OE Luar Bros (Husqvarna 525P4S) ka një peshë prej 5.3 kg.

Makina korrëse profesionale me karburant e paraqitur nga OE Luar Bros nuk përmbush specifikimet teknike pasi fuqia neto në RPM është 3000 rpm, ndërkohë që sipas specifikimeve teknike minimum duhet të jetë 3100 rpm.

4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “SI &CO Company” me NIPT: L21420002F

Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi “Si &CO Company” shpk nga ku rezulton se:

- **Nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim**
- **Nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST**

OE SI&CO nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit pasi nuk ka paraqitur asnjë prej deklaratave që u kërkohen OE pjesëmarrës pika a); b); c); ç); d).

OE SI&CO nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit pasi nuk ka paraqitur deklaratat përkatësisht pika c); ç); d).

OE SI&CO nuk plotëson pikën 2.3 (a) tek kapaciteti teknik pasi nuk ka paraqitur dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme të kryera 3 vitet e fundit.

OE SI&CO nuk plotëson pikën 2.3(c) pasi nuk ka paraqitur çertifikatë ISO 9001:2015 prodhuesi.

OE SI&CO nuk plotëson pikën 2.3(d) pasi nuk ka paraqitur document i cili deklaron llojin e mjeteve me foto si dhe specififikimet teknike të tyre.

OE SI&CO nuk plotëson pikën 2.3(e) pasi nuk ka paraqitur deklaratë garancie për mallrat e ofruar në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi, si dhe periudha teknike jo më pak se 3 muaj nga marrja në dorëzim e mallit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se operatori ekonomik **“Power Industries” shpk** me adresë Bulvard Gjergj Fishta, Qendra Alpas, Shkalla 2, Kati i 5, Apartamenti 14, Tiranë, me Administrator Z. Andi Marku se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **6 290 000 (gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh dhe 7 548 000 (shtatë milion e pesëqind e dyzet e tetë mijë) lekë me tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit të Qytetit, Tiranë sigurimin e kontratës, dhe nënshkrimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin

publik”, i ndryshuar.

Klasifikimi u bë me datë **05.06.2020** në sistemin elektronik të APP-së

Ankesa: Nuk ka

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arlinda Binjaku